



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KOMUNËS SË ISTOGUT PËR VITIN 2019**

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Istogut, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Shemsije Llugiqi udhëheqës e ekipit dhe të anëtarëve të ekipit Besim Lezi dhe Hysen Restelica, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Luljeta Morina.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	26
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	33
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	36

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore për Komunën e Istogut për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Procesi i përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore është menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të mos shpalesjes së pasurive jokapitale dhe stoqeve.

Sa i përket menaxhimit financiar, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet duhet edhe më tutje të përmirësohen. Në fushën e të hyrave duhet ti kushtohet më shumë rëndësi barazimit dhe menaxhimit të të hyrave nga qiraja, ndërsa edhe fusha e shpenzimeve është vlerësuar me parregullsi sidomos tek menaxhimi i prokurimeve, menaxhimit e pasurisë, detyrimeve si dhe llogarive të arkëtueshme.

Zbatimi i rekomandimeve të auditimit ende mbete sfidë për komunën. Nga 18 rekomandimet e dhëna vetëm gjashtë prej tyre janë zbatuar, një ishte në proces, tri janë mbyllur, ndërsa tetë nuk janë adresuar ende.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. ZKA vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Komunës së Istogut për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime)dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Istogut për vitin 2019 kishte shpenzuar në total 68% të buxhetit final. Realizimi i ulët i buxhetit është ndikuar nga financimi i huamarrjes (klauzola investive²) e cila ishte alokuar në total, përderisa sipas marrëveshjes³ ishte paraparë të implementohet vetëm 20% brenda vitit 2019 ndërsa pjesa tjetër për dy vitet në vijim. Nëse i referohemi realizimit të grantit Qeveritar dhe donacioneve të brendshme brenda vitit, Komuna ka shpenzuar 95% të buxhetit final nga këto fonde të destinuar.

Sa i përket menaxhimit financiar, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet duhet edhe më tutje të përmirësohen. Në fushën e të hyrave duhet ti kushtohet më shumë rëndësi barazimit dhe menaxhimit të të hyrave nga qiraja, ndërsa tek fusha e shpenzimeve duhet të shtoj kontrollet në zbatimin e proceduarve të prokurimit, planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve në kategori dhe kode adekuate, pagesave me vendime gjyqësore ku kostot janë rritur për shkak të shpenzimeve shtesë gjyqësore/përmbarimore. Gjithashtu, dobësi kishte edhe në regjistrimin e pasurisë, raportimin e detyrimeve dhe menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

2.Huamarrja "Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në Komunën e Istogut". Vlera e kontratës është 5,094,246€.

³ Për vitin 2019 janë shpenzuar vetëm 1,018,849.34€ ose pagesa e 20% të kontratës ashtu siç është e përcaktuar në marrëveshje.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ⁴	2019 Realizimi	2019 Realizimi %	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	10,678,115	16,627,532	11,298,093	68%	9,542,940	8,853,886
Granti i Qeverisë – Buxheti	9,306,243	9,443,276	9,047,397	96%	8,568,2260	7,734,102
Të bartura nga viti paraprak ⁵ -		566,393	357,316	63%	135,406	333,028
Të hyrat vetjake ⁶	1,277,578	1,277,578	834,101	65%	704,794	751,222
Donacionet e brendshme		57,867	33,130	57%	15,060	35,534
Donacionet e jashtme		188,172	7,300	39%	119,454	-
Financimet nga huamarrja	94,294	5,094,246	1,018,849	20%	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 5,949,417€. Kjo rritje është rezultat i bartjes së të hyrave vetanake nga viti paraprak, financimet nga huamarrja dhe grantet nga donatorët e brendshëm dhe të jashtëm.

Në vitin 2019, komuna ka shpenzuar 68% të buxhetit final ose 11,298,092€, me një ulje prej 23% krahasuar me vitin 2018 (91%).

⁴ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁵ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁶ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	10,678,115	16,627,532	11,298,093	68%	9,542,940	8,853,886
Pagat dhe Mëditjet	6,066,251	6,066,251	5,932,593	98%	5,861,876	5,638,899
Mallrat dhe Shërbimet	1,345,525	1,251,231	1,164,195	93%	904,245	764,047
Shërbimet komunale	155,000	155,000	154,686	100%	137,047	118,580
Subvencionet dhe Transferet	250,000	373,300	328,611	88%	251,784	262,018
Investimet Kapitale	2,861,339	8,781,750	3,718,008	42%	2,387,988	2,070,342

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

Buxhetit final për mallra dhe shërbime është zvogëluar për 94,294€ si rezultat i “Marrëveshjes së Mirëkuptimit mes Ministrisë së Shëndetësisë”. Buxheti final për subvencione dhe transfere është rritur 123,300€, si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak. Për kategorinë investime kapitale buxheti final ishte rritur për 5,920,411€, si rezultat i rritjes së grantit qeveritar për 137,034€⁷, të hyrave të bartura 443,093€, donacioneve të brendshme 57,867€, donacioneve të jashtme 188,171€ dhe financimit nga huamarrja 5,094,246€⁸.

⁷ Vendimi Qeveritar Nr.04/96 me dt.10.04.2019 për projektin e ri “ Zëvendësimi i gypit të Azbestit”.

⁸ Ndërtimi i sistemit të furnizimit me ujë për Komunën e Istogut

Çështja B1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Komuna në vitin 2019 përmes planifikimit buxhetor si dhe vendimeve gjyqësore ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 60,708€ në kategori ekonomike jo adekuate, si në vijim:

- Pagesat në vlerë prej 11,622€ ishin realizuar nga Thesari bazuar në vendimet gjyqësore/përmbartimore nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Prej tyre, pagesat në vlerë prej 4,122€ ishin për pagat jubilarë me rastin e daljes në pension të mësimdhënësit, si dhe pagesa në vlerë prej 7,500€ për projektin “Renovim i objektit të zjarrfikësve” i bartur për pagesë nga viti paraprak, i cili për nga natyra e shpenzimeve i takonin kategorisë investime kapitale; si dhe
- Për shkak të planifikimit buxhetor, komuna ka realizuar pagesa në vlerë prej 49,087€ në kategori joadekuate. Prej tyre, në katër⁹ raste shpenzimet në vlerë 40,087€ ishin keq klasifikuar në kategorinë e investimeve kapitale edhe pse për nga natyra i takonin kategorisë mallra dhe shërbime, dhe në një rast pagesa në vlerë 8,999€ për mirëmbajtje të rrugëve ishte regjistruar si mallë dhe shërbim ndërsa për nga natyra i takonte kategorisë së investimeve kapitale.

Në mungesë të mjeteve në kategorinë e duhur/adekuate pagesat janë kryer nga kategoritë tjera. Gjithashtu edhe mosrespektimi i afateve ligjore të pagesave ka shkaktuar vonesa në pagesën me kohë të obligimeve dhe kanë ndikuar zhvillimin e kontesteve gjyqësore.

Ndikimi

Pagesa e vendimeve gjyqësore si dhe keq buxhetimi për kategori jo adekuate ndikon në shpenzimin e buxhetit të destinuar për qëllime tjera, duke rrezikuar implementimin e projekteve apo arritjen e objektivave komunale të parashikuara me buxhetin e këtij viti. Kjo ka rezultuar edhe me kosto shtesë

⁹ “Mirëmbajtja e hapësirave publik në territorin e komunës 16,748€ (mallra) paguar nga IK regjistruar në kodin ekonomik 31270, nga projekti kapital 49061”; “Eliminimi i mbeturinave nga hapësirat publike vlera 8,279€, regjistruar 31270 nga projekti kapital 47796”; “Furnizimi me inventar për kopshtin e fëmijëve Gëzimi ynë -7,300€ kodi ekonomik 31690, projekti kapital 93226; pajisje me mjet teknologjikë - 7,760€paguar nga kodi ekonomik 31121 projekti kapital 48968 dhe 48966.

buxhetore si rezultat i ngarkesave në emër të kamatave dhe shërbimeve gjyqësore dhe të përmbarimit.

Rekomandimi B1 Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo nëse paraqitet nevoja të bëhet ridestnimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore. Pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate. Gjithashtu obligime e bartura duhet buxhetohen me fondet të mjaftueshme me qëllim të forcimit të disiplinës financiare për pagesën me kohë dhe evitimin e ballafaqimit me drejtësinë duke eliminuar edhe pasojat apo mundësin e shpenzimeve shtesë.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna e Istogut në 2019 ishin në vlerë 1,062,591€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Kemi testuar 20 mostra për teste substanciale në vlerë 118,788€, si dhe 44 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	2019 % e Pranimeve	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat	1,277,578	1,277,578 ¹⁰	1,083,543	85%	933,652	843,036

Realizimi i të hyrave gjatë vitit ka qenë më i ulët se sa planifikimi për 194,035€. Kjo për shkak se kishte rënie në inkasimin e të hyrave nga qiraja, në krahasim me vitin paraprak.

Përveç të hyrave të prezantuara në tabelë komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror (gjobat nga dënimet e policisë dhe gjobat nga Gjykatat) në vlerë prej 151,916€

¹⁰ Në planifikim janë përfshirë edhe të hyrat indirekte sipas Ligjit të buxhetit 158,750€.

Çështja A1 – Mangësi në menaxhimin dhe raportimin e të hyrave

Gjetja Sipas nenit 13 të rregullores financiare nr.03/2010 për Të Hyrat - Pas çdo mbyllje të periudhës mujore, OB është e obliguar që ta bëjë barazimin e të hyrave në Thesar. Komuna nuk kishte bërë barazimin e të hyrave duke përfshirë saldot mujore për të hyrat e inkasuara nga drejtoritë¹¹ në mënyrë sistematike (çdo muaj) me zyrtarën kryesore për të hyrat.

Mos barazimi ka ndikuar që të hyrat e realizuara sipas evidencave të zyrtares kryesore me evidencat nga departamentet që krijojnë të hyra, të jenë të ndryshme. Në Drejtorin e Urbanizmit të hyrave inkasuara në vitin 2019 për leje ndërtimi ishin në vlera totale prej 217,976€¹², ndërsa sipas zyrtares kryesore të hyrat nga lejet e ndërtimit ishin në vlerë 239,815€ që do të thotë kishte një diferencë mosbarazimi në vlerë 21,839€. Kjo ka ndodhur për shkak se deri më tani nuk ishte praktikuar barazimi i të hyrave mes drejtorive me zyrtarin kryesor të të hyrave.

Ndikimi Mos barazimet e të hyrave, ndikon në raportimin jo të drejtë të të hyrave apo evidentimin e të hyrave në kode të gabuara ekonomike.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se barazimet në mes të drejtorive përkatëse me zyrtaren kryesore për të hyrat kryhen në baza të rregullta mujore dhe të gjitha mospërputhjet e mundshëm të sqarohen me kohë.

Çështja A2 – Faturimi i tatimit në pronë dhe zonat komunale

Gjetja Kuvendi komunal i çdo komune cakton normat tatimore për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike në përputhje me Ligjin e Tatimit në Pronë e Paluajtshme nr.06/L-005, gjegjësisht nenit 9, Komuna posedon Rregulloren komunale për aplikimin e tatimit në pronë, ku bazuar në nenin 2 janë të përcaktuar katër zona komunale. Gjithashtu sipas nenit 12 të Ligjit të tatimit në pronë, komuna është përgjegjëse për menaxhimin e informatave tatimore mbi pronën dhe futja e të dhënave në bazën qendrore, si dhe përgatitja dhe lëshimi i faturave të tatimit.

Nga 17 mostrat e testuara, ne kemi identifikuar shtatë raste ku faturat e tatimpagueseve janë mbivlerësuar në total prej 100€, ndërsa në tetë raste tjera faturat e tatim paguesve ishin nënvlerësuar në total prej 67€, për arsye se kalkulimi sipas zonave nuk ishte në përputhje me zonat komunale (rrugët e qytetit) të përcaktuara sipas Rregullores së lart përmendur. Kjo ka ndodhur për

¹¹ Drejtoria e Urbanizmit, Administrata, drejtoria e Kadastrës, Gjeodezisë, Drejtoria e Arsimit dhe Shëndetësisë dhe Drejtoria e Tatimit në Pronë.

¹² Në analitiken e realizimit të të hyrave për vitin 2019

shkak se me rastin e futjes së të dhënave për aplikimin e tatimit në pronë kishte raste që të dhënat nuk ishin të sakta sipas pozicionimit të pronave në teren dhe zoonimit të tyre të përcaktuara në Rregullore (e njëjta rrugë ishte përfshi në dy apo me shumë zona) dhe kalkulimi i tatimit bëhej për pronat në të njëjtën rrugë me baza të ndryshme.

Ndikimi Mos aplikimi i ngarkesave të sakta ka reflektuar me ngarkesa të pa rregullta për qytetaret, duke ju ofruar mundësin e ankimimit si palë të dëmtuara. Derisa në anën tjetër nënvlerësimi i ngarkesave tatimore rezultoi me fonde më të ulëta nga këto të hyra.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj përditësimin e të dhënave në sistem duke paraqitur zonave tatimore krahas rregullores së aprovuar në kuvendin komunal.

Çështja B2- Shfrytëzim i pa rregulltë i pronave komunale

Gjetja Rregullorja nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme, në nenin 4 obligon komunën që dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme ta bëjë përmes procedurës së ankandit publik. Po ashtu, Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale 06/L-092¹³, neni 23 pika 1 cek: "Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës".

Menaxhimi i pronave të komunës të dhëna në shfrytëzim me karakter të përkohshëm mbetet sfidë për Komunën nga fakti se 41 qiramarrës kishin borxhe të pashlyera. Vlera e borxhit¹³ të pa mbledhur prej 13,930€, sipas informatave të ofruara nga komuna (raport komulativ me 07.11.2019) daton nga viti 2008 deri në fund të vitit 2019. Komuna nuk ka informata analitike për vlerën e saktë të borxhit.

Në vitin 2012, komuna përmes ankandit publik kishte dhënë në shfrytëzim tokën në Zonën industriale Sinaj Istog, për të cilën deri më tani nuk ka arritur të mbledhë borxhet. Katër kompani të cilat operojnë në këtë zonë nuk i kishin përmbushur obligimet tyre në vlerë totale prej 14,180€, ky borxh është evidentuar nga komuna deri në vitin 2016. Ndërsa zyrtaret komunal nuk kanë informata se këto parcela vazhdojnë të shfrytëzohen nga qiramarrësit dhe nuk posedojnë të dhëna tjera për borxhin nga viti 2016-2019. Komuna nuk ofron

¹³ Nga testimi i 10 rasteve, katër nuk kishin paguar qiratë që nga viti 2008, dhe katër raste nga viti 2010, 2014, 2015, 2016 nuk i kishin shlyer borxhet ndaj qirasë. Po ashtu dy raste tjera që shfrytëzonin objektet komunale nga viti 2018, nuk i kishin kryer obligimet e qirasë. Vlera e borxhit në total për këto 10 raste ishte 3,990€ duke pas parasysh që komuna tokat i ka dhëna në shfrytëzim të përkohshëm vite me pare me një çmim simbolik p.sh .te rastet sipërfaqe prej 6m² ka një qira vjetore prej 60€.

dëshmi për aktivitetet e ndërmarra për mbledhjen e borxhit, pas vitit 2016.

Për kundër faktit se ka borxhe të pashlyera të njëjtit (qiramarrësit) vazhdojnë të shfrytëzojnë pronat e komunës. Kjo situatë vjen si pasojë e neglizhencës nga zyrtaret e drejtorive përkatëse për aplikimin e masave (për shkëputjen e kontratave apo dërgimit në përmbarrim), të parapara me dispozita ligjore dhe me kontrata në rastet kur tatimpaguesit nuk i përfillin rregullat të cilat kanë përcaktuar të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e dy palëve.

Ndikimi

Mungesa e kontrollit efikas në menaxhimin e të hyrave nga pronat komunale të dhëna në shfrytëzim do të ndikojë në një shkallë të ulët të arketimit dhe akumulimi i vazhdueshëm i tyre si llogari të arketueshme rrit rrezikun e vjetërsimit të kërkesave. Gjithashtu, edhe operimi me kontrata të skaduar privon komunën nga e drejta për arkëtimin e të hyrave dhe ndjekjen e procedurave gjyqësore në raste të mos inkasimit të kërkesave me kohë.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të analizojë arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe sigurojë se prona komunale ofrohet për shfrytëzim vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave. Gjithashtu, duhet të shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e planifikuara do të realizohen.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 6,066,251. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 972 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 937. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 16 të rinj. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 62,072€, si dhe 18 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 1,251,231€, prej tyre ishin shpenzuar 1,164,195€. Ato kanë të bëjnë kryesisht shpenzimet për udhëtime zyrtare, shpenzime kontraktuese, mobile dhe pajisjeve të zyrës, derivate, shërbime të regjistrimit dhe sigurimit të pasurive, mirëmbajtje dhe riparim, marketingut dhe publikimit, përfaqësimit, avanset dhe vendimet gjyqësore. Kemi testuar 45 mostra për teste substanciale në vlerë 202,802€ si dhe 11 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Ndërsa buxheti final për shërbime komunale ishte në vlerë prej 155,000€ i cili ishte shpenzuar 100%.

Çështja B3 - Mbulimi i pozitave të rregullta të punës me kontrata për shërbime të veçanta

Gjetja

Rregulla financiare 01/2013 në nenin 33 specifikon që të gjithë personat në marrëdhënie pune të pagohen përmes listës së pagave. Ligji për Shërbimin Civil nr.03/L-149 në nenin 12 përcakton se emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të

quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta”.

Komuna ka angazhuar 42 punonjës me marrëveshje për shërbime të veçanta. Prej tyre 28¹⁴ janë angazhuar me kontrata punë me kohë të caktuar bazuar në Ligjin e Punës dhe 14 ishin me marrëveshje për shërbime të veçanta bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil.

- Përveç 23 rasteve që komuna ka zhvilluar proces të thjeshtuar të rekrutimit, marrëveshjet tjera janë ripërtëritë (sepse të njëjtit ishin të angazhuar edhe në vitin e kaluar) duke mos zhvilluar asnjë procedurë të angazhimit.
- Shumica e këtyre personave janë angazhuar për të mbuluar pozitat të përhershme të punës¹⁵. Ndërsa, kontratat e punës për detyra specifike janë lidhur me personat që janë angazhuar për ti kryer punët¹⁶ të cilat nuk ishin të natyrës specifike.
- Përveç gjashtë rasteve të bartura nga viti 2018 me të cilët ka vazhduar marrëveshjet edhe për këtë vit¹⁷, edhe në tri raste tjera ka lidhur dy marrëveshje me të njëjtit persona, duke marr shërbimet e njëjta me gjatë se gjashtë muaj brenda vitit.

Sipas zyrtarëve komunal, mangësitë e identifikuar në vitin paraparak janë bartur edhe këtë vit, kjo si pasojë e mungesës së buxhetit për punësimin e staf të ri për programet e përhershme dhe aprovimit të kufizuar të vendeve të punës nga Ministria e Financave krahasuar me kërkesat.

Ndikimi

Ripërtëritja e kontratave për marrëveshje të shërbimeve të veçanta përgjatë vitit si dhe mos aplikimi i procedurave të thjeshtësuara të rekrutimit paraqet anashkalim të dispozitave të përcaktuara ligjore, kufizon konkurrencën dhe rritë rrezikun që përfitimi i shërbimeve të mos jenë reale krahas kërkesave kontraktuale dhe pritjeve.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj ndërprerjen e një praktike të tillë të angazhimeve dhe për pozitat e rregullta të punës për të cilat ka nevoja afatgjata kërkesat t’i adresoj me rastin e planifikimit buxhetor, dhe të njëjtat në vazhdimësi t’i trajtoj dhe diskutoj me MF. Ndërsa në rast të paraqitjes së nevojave për shërbime të veçanta apo punë specifike duhet të sigurojë se për marrëveshjet për shërbime të veçanta

¹⁴ Drejtorati i Kulturës 14 angazhuar me kontrata punë me kohë të caktuar dhe Drejtoria e shëndetësisë gjashtë të angazhuar me kontratë punë me kohë të caktuar.

¹⁵ Inspektor të veterinarëve, zyrtar për siguri të përgjithshme, zyrtar për shërbim me qytetaret, inspektor i komunikacionit.

¹⁶ Roje në shtëpi të kulturës, roje në pylltari, roje autoparku, pastruese, ndihmëse mjekësore, teknike e dhëmbëve, specialist i mjekësisë familjare, mjek i përgjithshëm i QKMF-së, mirëmbajtës në QKMF, motër edukatore.

¹⁷ Me të njëjtit komuna ka vazhduar edhe nga dy MSHV, nga 6 respektivisht 3 muaj.

të respektohen të gjitha kërkesat ligjore në fuqi.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 373,300€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 328,610€. Ato kanë të bëjnë me mbështetje të aktiviteteve kulturore, sportive dhe ndihma momentale. Kemi testuar tetë mostra për teste substanciale në vlerë 89,248€ si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Mungesa e planit vjetor për financimin publik të OJQ-ve

Gjetja Sipas Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret Standarte dhe Procedurat të Financimit publik të OJQ-ve neni 6 (Plani Vjetor i Mbështetjes Financiare) ka definuar se ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Komuna për vitin 2019 nuk ka përgatitur planin vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve i cili do të duhej të dorëzohet para miratimit të buxhetit vjetor. Zyrtarët e komunës e konfirmuan se nuk kanë përgatitur plan vjetor për mbështetje financiare, mirëpo nuk dhanë arsyen e mos përmbushjes së këtij kriteri ligjor.

Ndikimi Mungesa e planit për caktimin e aktiviteteve me më prioritet për mbështetje financiare në fusha të caktuara si dhe caktimin e objektivave për realizimin e tyre rrezikon që fondet publike të destinohen për projekte me pak të favorshme për qytetaret.

Rekomandimi A3 Kryetari të siguroj se drejtoritë të cilat mbështesin financiarisht entitetet jo publike kanë përgatitur planin vjetor të mbështetjes financiare para miratimit të buxhetit vjetor. Në mbështetje të këtij plani fondet do të shpërndahen sipas prioriteteve dhe objektivave të caktuara për aktivitetet në fusha të caktuara me një kosto duke u respektuar parimi i eefktivitetit dhe ekonomizimit për shpenzimet e krijuara.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 8,781,750€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 3,718,008€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime për rregullim të infrastrukturës, ndërtim i rrugëve, kanalizimit, trotuareve, ndërtim dhe mirëmbajtja e objekteve, pajisje dhe përmirësime të ndryshme të pasurive kapitale. Kemi testuar 58 mostra për teste substanciale në vlerë 2,163,576€, si dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B4 – Ndryshimi i sasive të paramasës për kontratat jo kornizë pa aprovimin e ZKA-së

Gjetja Sipas nenit 61 pikave 21, 22 dhe 23 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurimin publik, ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer. Ndryshimi i kontratës iniciohet nga menaxheri i kontratës. Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit. Ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA.

Në dy¹⁸ raste, pagesat në vlerë totale 40,061€, për kontratat jo kornizë, kishte ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke i rritur/zvogëluar mbi 10% sasinë e kontraktuar, por pa ndryshuar çmimin total të kontratës. Për këto ndryshime nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme nga ZKA. Kjo ka ndodhur për shkak se, menaxherët e projekteve nuk ishin në njohuri për kërkesat ligjore lidhur me përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e kontratës.

Ndikimi Ndryshimi i masës dhe llogarisë së punëve të kontraktuar pa aprovimin e ZKA-së shpërfaq mungese të kontrolleve dhe menaxhim të dobët të kontratës. Kjo reflekton një specifikim dhe projektim jo adekuat për punët e kontraktuar dhe kontrolle jo adekuat për punët e pranuar. Planifikim i dobët i nevojave nuk siguron ofertim konkurrues dhe transparent, mund të rezultojë edhe me shfrytëzimin jo ekonomik të fondeve apo kosto më të larta për shkak të sasive/masave të përcaktuar jo drejt në dosjen e tenderit.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë se përcaktimi i saktë i nevojave dhe specifikimi i punëve duhet të përgatitet dhe projektohet para fillimit të tenderimit dhe në monitorimin e kontratave si organ mbikëqyrës, të përfshihet stafi kompetent që janë të njoftuar me përgjegjësit e përcaktuar me LPP. Nëse paraqitet nevoja për ndryshim të termeve dhe kushteve të kontratës, organi mbikëqyrës duhet të inicioj dhe arsyetoj pranë zyrës së prokurimit këto ndryshime e cila ka përgjegjësin për kontratën dhe marrin aprovimet nga nivelet relevante.

¹⁸ Kontrata "Eliminimin i mbeturinave nga hapësirat publike" - vlera kontratës 8,950€, (Poz.1 +61.60%, poz. 2 +36.60%, poz. 5 +11.60% dhe poz.6 realizimi zero); Kontrata " Fasadimi i ndërtesave (banesave kolektive në rrugën Rinia në Istog"- vlera e kontratës 31,111.11€ (poz. 1.3 -26.79%, poz. 1.4 +145.83%, poz. 1.5 +437.50%, poz. 1.6 -31.46%, poz. 1.7 -31.46%, poz. 4 -31.46% dhe pozicioni 1.11 realizimi zero).

Çështja A4 - Oferta fituese jo ekonomike

Gjetja

Në proceset e prokurimit ku përdoret procedura e hapur dhe kriteri për dhënie të kontratës çmimi më i ulët, duhet të rezultojë me kontratën më ekonomike për Autoritetin Kontraktues (AK). Neni 1 pika 3 i Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës kërkon nga personat zyrtar që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit që të sjellën duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Për kontratën Loti I "Ndërtimi i rrugës Hul Huli- Istog i Poshtëm"¹⁹ së bashku me Aneks²⁰ kontratën, ne kemi krahasuar ofertën fituese me ofertat e Operatorëve të tjerë të vlerësuar si të përgjegjshëm gjatë procesit të prokurimit. Ne kemi vërejtur se në implementimin e kontratës OE fitues ishte më i shtrenjtë se sa ofertuesi tjetër i pa suksesshëm për 3,592€. Gjithashtu në kontratën tjetër Loti III "Asfaltimi i rrugës në lagjen Dekaj-Istog i Poshtëm" në implementim kontratës OE fitues ishte më i shtrenjtë se sa ofertuesi tjetër i pasuksesshëm për 2,302€.

Komuna posedonte projektin ekzekutiv dhe rrjedhimisht ka pasur të dhëna rreth sasive të kërkuara për realizimin e projektit. Mirëpo nuk ishte përcaktuar paramasën dhe parallogarinë për secilin artikull që do ta ndihmonte Autoritetin Kontraktues në përzgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët, parimit të ekonomizimit. Ky aktivitet është publikuar me çmim për njësi me kërkesë të njësisë kërkuese me arsyetim që infrastruktura rrugore është interes i komunitetit dhe për arsye të shfrytëzimit të parasë publike.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos zbatim të procedurës të kriterëve të përzgjedhjes së operatorëve ekonomik fitues, duke mos pasur parasysh peshën e artikujve në çmimin total.

Ndikimi

Vlerësimi i dobët i nevojave ka rezultuar me kosto më të lartë të punëve dhe mos arritjes së vlerës për paranë e shpenzuar.

Rekomandimi A4 Kryetari i komunës duhet të siguroj se njësitë kërkuese në bashkëpunim me zyrën e prokurimit bëjnë një analizë të detajuar të vlerësimit të nevojave që të arrihet shfrytëzimi sa më ekonomik i fondeve publike.

¹⁹ Kontrata "Ndërtimi i rrugës Hul Huli-Istog i Poshtëm Lot 1" vlera e kontratës 40,000€

²⁰ Kontrata "Ndërtimi i rrugës Hul Huli-Istog i Poshtëm-punë shtesë" vlera e kontratës 3,739€.

2.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B5 - Shpenzime shtesë si pasojë e pagesave përmes vendimeve gjyqësore-përmbarrimore

Gjetja Komuna në vitin 2019 kishte realizuar pagesa bazuar në vendimet gjyqësore sipas nenit 40 LMFP në vlerë prej 44,159€ dhe pagesa sipas nenit 39.2 në vlerë 7,500€. Në dy raste pagesat sipas vendimeve gjyqësore në vlerë 13,637€ janë përcjell me shpenzime shtesë prej 2,710€ si në vijim:

- Pagesa në vlerë 9,515€ (borxhi kryesor 8,165€, kamata 480€ dhe shpenzime të tjera gjyqësore 870€) për kompensimin²¹ e dëmit material që komuna kishte shkaktuar në një palujtshmëri (pronë private). Në regjistrin e detyrimeve kontigjente²² të përgatitur nga zyra ligjore, nuk ishte prezantuar kjo pagesë si detyrim kontigjent, edhe pse në vitin 2015 gjykata kishte nxjerrë vendimin për kompensimin e dëmit nga komuna si e paditur në këtë rast.
- Pagesat me vendim gjyqësorë në vlerë 4,122€ (borxhi kryesor 2,762€, kamata 1,184€ dhe shpenzime të tjera gjyqësore 176€), për pagë jubilarë si dhe për dalje në pension të mësimdhënësit.

Ndikimi Pagesat e detyrueshme me vendim gjyqësor, jo vetëm që kanë ndikuar në shpenzimin e buxhetit të destinuar për qëllime tjera, por kanë vënë në rrezik implementimin e projekteve apo arritjen e objektivave komunale të parashikuar me buxhetin e këtij viti. Kjo ka rezultuar edhe me kosto shtesë buxhetore si rezultat i ngarkesave në emër të kamatave, shërbimeve gjyqësore dhe të përmbarrimit.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të siguroj se bëhet planifikim i mirëfilltë i buxhetit, duke forcuar disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë dhe të marr masat e duhura për menaxhimin obligimeve për të evituar proceset gjyqësore të cilat bartin shpenzime shtesë.

²¹ Demi I shkaktuar material nga vendosja e kanalizimit të qytetit në parcelën private, ngastrat kadastrale 01662/1 dhe 01662/3.

Çështja B6 - Kontrata e nënshkruar në mungesë të fondeve (zotimeve) të mjaftueshëm

Gjetja LMFP Nr. 03/L-221 neni 36.1 thotë se: Para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, Organizata Buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në SIMFK në përputhje me rregullat KMF.

Kontrata kornizë një vjeçare për “Furnizim me lëndë djegëse për institucionet komunale” e cila përfshin dy sezona dimërore 2019/2020 ishte nënshkruar pa zotim të mjaftueshëm të fondeve. Vlera totale indikative e kontratës ishte 110,673€, derisa zotimi i mjeteve për to ishte vetëm 20,000€. Sipas zyrtarëve zotimi i mjeteve bazohet në planifikimin e të hyrat vetjake dhe mjetet do zotohen varësisht prej realizimit të të hyrave.

Ndikimi Zotimet më të ulëta se vlera e kontraktuar me rastin e nënshkrimit të kontratave ekspozon komunën para një rreziku të hyrjes në obligime përtej shumës që tejkalon fondet e ndara dhe ndikon në mos realizimin e projekteve të planifikuara.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetjake apo fonde tjera të financimit.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 21,403,153. Ndërsa vlera e pasurive jokapitale dhe e stokeve nuk janë shpalosur. Kemi testuar 98 mostra për teste substanciale në vlerë 2,186,755€ si dhe 20 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B7 – Mangësi në regjistrat kontabël të pasurisë

Gjetja

Gjatë auditimit të regjistrave kontabël identifikuam si në vijim:

- Bazuar në nenin 4 pika 1 të rregullores MF-nr.02/2013-për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare.

Komuna ende nuk ka aprovuar rregulla dhe procedura të brendshme për evidencën ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë.

- Sipas nenit 6 të rregullës MF nr.01/2017 për Raportimin vjetor financiar nga OB- Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare.

Komuna në PFV e vitit 2019 nuk kishte shpalosur vleren e pasurive jo kapitale nën 1,000€ si dhe stoqeve.

- Sipas rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë neni 6, pika 3 - Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”. Ndërsa neni 13, pika 2, blerja dhe ndërtimi i pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore përcakton se në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve.

- Komuna kishte përdorë pjesërishtë programin e-pasuria për evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë nën 1,000€. Administrata e komunës përdorë sistemin e-pasuria, përderisa drejtorja e arsimit dhe shëndetësisë aplikojnë programin Excel për evidentimin e kësaj pasurie, ndërsa sa i përketë stoqeve komuna nuk kishte bërë verifikim të tyre në fund të vitit para përgatitjes së PVF-ve. Mirëpo për shkak të mundësisë së ndryshimit të të dhëna dhe sigurisë së kufizuar të programit, vlera e pasurisë nën 1,000€ e ofruar nga komuna nuk mund të konsiderohet si saktë²³.

Kjo kishte ndodhur për shkak të neglizhencës dhe mungesës së angazhimit për të zbatuar kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare.

- Në fund të vitit 2019 Parcelat komunale me vlerë të përafërt 87,288,488€²⁴ nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurisë në

SIMFK. Por zyrtarja e pasurisë ka sjell dëshmie se deri me dt. 21.07.2020 ishin regjistruar parcelet në vlerë 32,050,032€.

- Dy pagesa në vlerë 23,300€²⁵ ishin regjistruar si pasuri kapitale në SIMFK, këto pagesa i takojnë pasurive nën 1,000 dhe do duhej të regjistroheshin në regjistrin “e-pasuria”;
- Komuna kishte pranuar pasuri kapitale nga palët e jashtme, në vlerë prej 47,221€ për projektin²⁶ i implemetuar në objektin e SHFMU “Martin Camaj” Istog, i njëjti nuk ishte regjistruar në evidencat e SIMFK-së;
- Furnizimet nga kodi i mobileve dhe pajisjeve nën 1,000€ për vitin 2019 ishin 61,702€, prej tyre në sistemin e-pasuria ishin regjistruara vetëm 37,832€; dhe
- Në tetë²⁷ raste kemi evidentuar se vlera prej 203,107€ ishte regjistruar sipas vlerës totale të kontratave/pagesave që janë bërë dhe jo sipas vlerës së projekteve të përfshira brenda kontratave përkatëse. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 6.1 i Rregullores nr. 02/2013. Pagesat kryesisht janë për asfaltimin e

²³ Ne kemi pranuar një raport nga sistemi i e-pasurisë siguruar nga zyrtari (vlera në libra 200,162.57€). Po ashtu kemi një vlerë të konstatuar nga komisioni i vlerësimit të pasurive nga drejtoria e arsimit dhe shëndetësisë (vlera shëndetësi 52,717, vlera arsim 280,987.50€, totali= 333,705 €) të cilët nuk përdorin sistemin e e-pasurisë.

²⁴ Vlerësimi i parcelave është bërë nga kompania e kontraktuar duke u bazuar në të dhënat mbi pronën dhe bazuar në parimet e mass valuation.

²⁵ “Pajisja e punëtorisë së makinerisë me mjete përkatëse –Mit’hat Frashëri Gurrakoc” mbivlerësimi 22,800€ dhe “Blerja e pajisjeve mjekësore për qendrën e mjekësisë familjare në ISTOG” mbivlerësimi 500€.

²⁶ Projekti “Auditimi energjetik i ndërtesave publike dhe ndërmarrje të tjera të obligueshme- Programi mbështetës- Zbatimi i masave të eficientës së energjisë në objektet publike (III)”, me Nr identifikues 213/019/010/521. Marrëveshja e mirëkuptimit në mes të MZHE dhe Komunës së Istogut për kalimin e pronësisë kapitale e datës 27.12.2019.

²⁷ Ndërtimi i kanalizimit në lagjen Blakaj-Llukavc, Lagja Kadaj-Lubozhde, Lagja Llullaku Cërrcë, Lagja Bajramaj-Istog, Vrellë dhe Ujësjellësi në Istog-Lagja Bytyqi-Lot 1, çmimi i kontratës 35,702€, vlera e pagesës 35,000€; Ndërtimi i trotuareve Istog-Dushkajë-Dubravë, Lot 5, çmimi i kontratës 17,415€, vlera e pagesës 5,000€; Ndërtimi i trotuareve Istog-Dushkajë-Dubravë, Lot 5, çmimi i kontratës 17,415€, vlera e pagesës 3,215€; Ndërtimi i rrugëve në Gurrakoc Lot 2, çmimi i kontratës 53,565€, vlera e pagesës 30,434€; Ndërtimi i rrugëve në Banjë-Lot 1, çmimi i kontratës 54,824€, vlera e pagesës 49,299€; Ndërtimi i rrugëve në Istog, çmimi i kontratës 104,989€, vlera e pagesës 12,183€; Ndërtimi i rrugëve në Istog, çmimi i kontratës 104,989€, vlera e pagesës 50,823€; Ndërtimi-Asfaltimi i rrugës në Vrellë çmimi i kontratës 31,493€, vlera e pagesës 20,453€.

rrugëve dhe zgjerimin e infrastrukturës. Përderisa evidentimi i tyre në regjistrin e pasurisë ishte bërë me një numër identifikues për vlerën totale të kontratës duke mos i specifikuar rrugët me numër identifikues individual.

Zyrtarja e pasurisë përgjegjëse për SIMFK ishte në pushim lehonie, dhe se brenda kësaj periudhe zyrtarët alternativ kishin regjistruar një numër simbolik të transaksioneve në sistem.

Ndikimi Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton menaxhim të dobët të pasurisë, si pasoj ndikon në mbi/nënvlërësim të pasurive si dhe në prezantimin jo të drejtë të pasurisë në pasqyra financiare.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale, të krijojë një sistem efikas të komunikimit dhe raportimit të të dhënave mes drejtorive dhe ZKF-së në mënyre që informatat e shpalosura në PFV të jenë të sakta dhe të besueshme për përdoruesit dhe palët e jashtme, të funksionalizojë sistemin e-pasuria nëpër të gjitha drejtoritë si dhe të hartojë rregullore dhe procedura të brendshme për menaxhimin e pasurive. Të gjitha këto për menaxhim efektiv të pasurive me qëllim që regjistrat kontabël të paraqesin gjendjen reale të pasurive.

2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,286,575€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 1,090,238€, lejet e ndërtimit 12,206€, ngarkesat për afarizëm të bizneseve 174,831€ dhe ngarkesa për shërbime të pijeve alkoolike 9,300€.

Çështja B8 - Rritje e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Trendi i të arkëtueshmeve është në rritje të vazhdueshme nga viti në vit. Në vitin paraprak të arkëtueshmet ishin 1,265,181€ dhe se krahasuar me vitin 2019 të arkëtueshmet janë rritur për rreth 2%, kryesisht të tatimi në pronë. Shkaqet e rritjes së të arkëtueshmeve janë veprimi i pamjaftueshëm i komunës që përmes përmbaruesve dhe veprimeve të zvogëlojë borxhin e pa mbledhur nga klientët.

Ndikimi Rreziku i mos arkëtimit të të hyrave ndikon që shumë projekte kapitale të mos realizohen për shkak të mungesës së mjeteve. Mungesa e kontrollit dhe mos aplikimi i masave adekuate pamundëson arkëtimin dhe rrit rrezikun e vjetërimit të kërkesave.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve për rritjen e arkëtimit.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 159,181€²⁸. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Krahasuar me vitin 2018 obligimet janë rritur për 16,760€.

Çështja B9 - Mungesa e raportimit të detyrimeve të papaguara

Gjetja Neni 5.2 i Rregullës financiare nr. 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore thotë: "Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave - Thesar të raportojnë obligimet e tyre të papaguara. Raportimi, sipas kësaj rregulle financiare, bëhet përmes raporteve mujore".

Komuna edhe gjatë vitit 2019 nuk kishte raportuar detyrimet e papaguara.

Kjo gjendje ishte për shkak të neglizhencës së zyrtarit përgjegjës për raportimin e detyrimeve të papaguara dhe për shkak të mungesës së procedurave të qarta formale për menaxhimin e procesit të pranimit, regjistrimit dhe raportimit të faturave.

Ndikimi Mos raportimi i rregulltë i të gjitha obligimeve në raportet mujore, paraqet pasqyrim jo të drejtë të detyrimeve, dhe do të shkaktoj vonesat në pagesa që mund të ndikojë në krijimin implikimeve buxhetore për vitin fiskal vijues.

Rekomandimi B9 Kryetari duhet të ndërmarrë masa shtesë të respektohet Rregulla financiare nr. 02/2013, që raportimi i detyrimeve të papaguara të bëhet në Thesar në baza mujore. Për më tepër të delegohet përgjegjësia të zyrtari i caktuar, i cili do të menaxhoj procesin që nga pranimi i faturës, protokolimin e saj dhe dorëzimi për ekzekutim (pagesë) ndaj furnitorit.

2.4.2 Detyrimet kontigjente

Detyrimet kontigjente ishin në vlerë prej 906,954€ që krahasuar me vitin paraprak ishin zvogëluar për 267,276€. Megjithatë, kjo pasqyron një nga vështirësitë buxhetore që komuna do të përballet në të ardhmen.

²⁸ Kjo shumë është prezantuar nga komuna.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Komuna e Istogut në fund të vitit 2019 sipas evidencave të prezantuara 104,046€ ka bartur detyrime kontraktuale në vitin 2020, të cilat kryesisht ishin projekte dhe kontrata pune për investime kapitale.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me Drejtorin e NjAB-së dhe një auditor.

Në vitin 2019, ishin finalizuar tri raporte nga katër raportet e planifikuara në planin vjetor të auditimit. Auditimet kanë mbuluar drejtoritë e ndryshme dhe ishin të fokusuara kryesisht në fushën e shpenzimeve, të hyrave dhe menaxhimit të pasurisë.

Në këto raporte ishin dhënë gjithsej 25 rekomandime prej tyre: 10 ishin zbatuara, shtatë ishin në proces të zbatimit dhe tetë rekomandime ishin të pa zbatuara. Komiteti i Auditimit ishte aktiv gjatë vitit duke mbajtur tri takime.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të Komunës së Istogut ka rezultuar në 18 rekomandime kryesore.

Komuna ka dorëzuar dy raporte për progresin mbi zbatimin e rekomandimeve (me 04.10.2019 dhe 22.06.2020) sipas kërkesave bazuar në Rregulloren e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, gjashtë rekomandime janë zbatuar, një ishte në proces, tetë nuk janë adresuar ende dhe tri janë mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV- Ref.	Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Në procesin e buxhetimit të gjitha shpenzimet duhet të buxhetuar në përputhje me planin kontabël. Më tutje, e gjitha pasuria, përfshirë pronat duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë. Po ashtu, shpalosjet e llogarive të arkëtueshme dhe detyrimet kontingjente duhet të jenë prezantuar në mënyrë të plotë dhe saktë në PVF-të për vitin 2019. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Komuna ka shpalosur LLA dhe detyrimet kontingjente në PVF-të. Derisa nuk janë marr masa për adresimin e klasifikimit të drejt të shpenzimeve dhe regjistrimin e plot të pasurisë.	Pjesërisht i zbatuar.
2	Nivel i ulët i realizimit të buxhetit për IK	Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit me kohë dhe në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.	Përkundër përpjekjeve realizim i buxhetit mbetet i ulët për IK nga të hyrat vetjake, ndërsa granti është realizuar afër 90 %.	I mbyllur i pa zbatuar.
3	Të hyrat	Kryetari duhet të analizoj arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe siguroj se dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale të bëhet vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave. Gjithashtu, duhet të shqyrtohen në mënyra aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e dakorduara janë realizuar.	Gjatë vitit 2019 ka filluar procesi i identifikimit të pronave komunale, është paraparë të përfundonte gjatë vitit 2019, i cili nuk ka arrit të përfundohet.	I pa zbatuar.
4	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, duhet të siguroj ndërprerjen e një praktike të tillë të angazhimeve dhe për të gjitha pozitat e rregullta të punës për të cilat komuna ka nevoja afatgjata kërkesat t'i adresoj me rastin e planifikimit buxhetor, duke bërë kërkesë për rritje të stafit dhe t'i trajtoj dhe diskutoj me MF. Pagesat e tilla duhet kryer nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.	Komuna ende vazhdon të angazhoj staf me MSHV, apo për punë specifike.	I pa zbatuar.

5	Pagat dhe mëditjet -	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë hapa konkret për përmirësimin e kontrolleve mbi dosjet e personelit në mënyrë që të gjitha dosjet të jenë të kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm. Kompletimi i dosjeve të behët brenda një afati tre mujor pas pranimit të këtij raporti.	Komuna nuk ka arritur të kompletoj dosjet e personelit as këtë vit.	I mbyllur.
6	Investimet kapitale -	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit që të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me punë të mos iniciohen pa u siguruar se ekziston edhe projekti ekzekutues. Parapërgatitjet e duhura për një projekt do të kenë ndikim edhe në hartimin e specifikimeve të qarta, por edhe do të eliminohen pengesat si të vonesave ashtu edhe të kostove shtesë.	Është përzgjedhë kompania projektuese për hartimin e projekteve ekzekutive.	I zbatuar
7	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që në asnjë rast nuk mund të ketë tejkalime të punëve shtesë mbi 10% nga kontrata origjinale dhe në rastin e punëve shtesë menaxheri i prokurimit duhet t'i ndjek të gjitha rregullat e prokurimit që kërkohen. Po ashtu, duhet të vendoset sistemi i llogaridhënies në rastet e ndryshimit të pozicioneve (prodhuesit) dhe vonesave të punimeve të paaprovuara. Një monitorim i vazhdueshëm i menaxhimit të proceseve të prokurimit është i domosdoshëm nga menaxhmenti, në rastet e projekteve komplekse.	Nuk është tejkaluar vlera e lejuar me ligj për punë shtesë për kontratat jo kornizë.	I zbatuar
8	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i prokurimeve përfshirë procesin e vlerësimit ushtrohen në harmoni të plotë me kriteret e vendosura dhe ofertuesit që nuk janë në përshtatshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit të mos shpërblehen me kontratë. Po ashtu të aplikohet sistemi i llogaridhënies në rastet e mos kryerjes së punëve sipas kërkesave ligjore.	Janë ndërmarrë masa që procesi i vlerësimit të mbështetet në kërkesat e ligjit të prokurimit publik.	I zbatuar
9	Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e pagesave për tu siguruar se pagesat do të realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmive të mjaftueshme për kryerjen e punëve/shërbimeve të kontraktuara.	Janë ndërmarrë veprimet për zbatimin e rekomandimit.	I zbatuar.

10	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë në njohuri me kërkesat e prokurimit publik, raportohet për çdo largim nga termat dhe kushtet e kontratës. Po ashtu, çdo ndryshim në kushtet e kontratës duhet të arsyetohet dhe aprovohet nga zyra e prokurimit dhe ZKA.	Komuna nuk ka ndërmarr masa për zbatim të këtij rekomandimi.	I pa zbatuar.
11	Çështjet e përbashkët a për MSH dhe IK	Kryetari duhet të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen dhe paguhen brenda afateve ligjore për të shmangur mundësinë e kostove shtesë. Po ashtu, duhet shtuar kujdesin lidhur me mënyrën e menaxhimit të procesit të pranimit dhe regjistrimit të faturave.	Ketë vit ka pasulej të pagesave me vendim gjyqësorë mirëpo prapë komuna ka paguar shpenzim shtesë.	I pa zbatuar.
12	Çështjet e përbashkët a për MSH dhe IK	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetjake apo fonde tjera të financimit.	Edhe përkundër përpjekjeve nga komuna, situata mbetet e njëjtë tek kjo çështje.	I pa zbatuar.
13	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të siguroj menaxhim efektiv të pasurive me qëllim që regjistri i pasurive të prezantoj gjendjen reale të pasurive, pra që vlera e pasurive të mos jetë e mbivlerësuar e as e nënvlerësuar. Po ashtu, duhet siguruar trajnime adekuate për zyrtarin e pasurive me qëllim që kompetenca të jetë në nivelin e duhur për të shmangur të gjitha paqartësitë me të cilat ballafaqohet zyrtari i pasurive gjatë evidentimit dhe menaxhimit të pasurive.	Komuna edhe ketë vit përballet me problemin e evidentimit dhe menaxhimit të pasurive.	I pa zbatuar.
14	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit plotësisht para përgatitjes së PFV-ve. Raporti duhet të përfshijë krahasimin e gjendjes fizike me atë në gjendjen e regjistrave. Nëse konstatohen diferenca ato duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.	Komuna ka ndërmarr masa për zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar.

15	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet ndërmerren veprime ligjore përmes përmbaruesve, kurse te qiramarrësit borxhli të ndërmerr masa për marrjen e objekteve dhe tokës që janë duke e shfrytëzuar dhe dhënien në shfrytëzim personave tjerë në përputhje me procedurat e ankandit publik.	Veprimi i pamjaftueshëm i komunës që përmes përmbaruesve dhe veprimeve tjera ligjore për zvogëlim të LLA, reflekton të njëjtën situatë edhe këtë vit.	I pa zbatuar.
16	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.	Situata rezulton e njëjtë me vitin e kaluar.	I pa zbatuar.
17	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari në bashkëpunim me KA-në dhe NjAB-së duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe të marrë të gjitha veprimet ndaj njësisve administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.	Janë ndërmarr masa për zbatim të këtij rekomandim.	I zbatuar.
18	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.	Organizata ka hartuar regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura. Ka raportime të rregullta të menaxhmenti I lartë.	I mbyllur i zbatuar.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo nëse paraqitet nevoja të bëhet ridestini i mjeteve sipas kërkesave ligjore. Pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate. Gjithashtu obligime e bartura duhet buxhetohen me fondet të mjaftueshme me qëllim të forcimit të disiplinës		

		financiare për pagesën me kohë dhe evitimin e ballafaqimit me drejtësinë duke eliminuar edhe pasojat apo mundësin e shpenzimeve shtesë.
2	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se barazimet në mes të drejtorive përkatëse me zyrtaren kryesore për të hyrat kryhen në baza të rregullta mujore dhe të gjitha mospërputhjet e mundshëm të sqarohen me kohë.
3	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj përditësimin e të dhënave në sistem duke paraqitur zonave tatimore krahas rregullores së aprovuar në kuvendin komunal.
4	Të hyrat	Kryetari duhet të analizoj arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe siguroj se prona komunale ofrohet për shfrytëzim vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave. Gjithashtu, duhet të shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e planifikuara do të realizohen.
5	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të siguroj ndërprerjen e një praktike të tillë të angazhimeve dhe për pozitat e rregullta të punës për të cilat ka nevoja afatgjata kërkesat t'i adresoj me rastin e planifikimit buxhetor, dhe të njëjtat në vazhdimësi t'i trajtoj dhe diskutoj me MF. Ndërsa në rast të paraqitjes së nevojave për shërbime të veçanta apo punë specifike duhet të sigurojë se për marrëveshjet për shërbime të veçanta të respektohen të gjitha kërkesat ligjore në fuqi.
6	Subvencionet dhe transferet	Kryetari të siguroj se drejtoritë të cilat mbështesin financiarisht entitetet jo publike kanë përgatitur planin vjetor të mbështetjes financiare para miratimit të buxhetit vjetor. Në mbështetje të këtij plani fondet do të shpërndahen sipas prioriteteve dhe objektivave të caktuara për aktivitetet në fusha të caktuara me një kosto duke u respektuar parimi i eefktivitetit dhe ekonomizimit për shpenzimet e krijuara.
7	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroje se përcaktimi i saktë i nevojave dhe specifikimi i punëve duhet të përgatitet dhe projektohet para fillimit të tenderimit dhe në monitorimin e kontratave si organ mbikëqyrës, të përfshihet stafi kompetent që janë të njoftuar me përgjegjësit e përcaktuar me LPP. Nëse paraqitet nevoja për ndryshim të termeve dhe kushteve të kontratës, organi mbikëqyrës duhet të inicioj dhe arsyetoj pranë zyrës së prokurimit këto ndryshime e cila ka përgjegjësin për kontratën dhe marrin aprovimet nga nivelet relevante.
8	Investimet kapitale	Kryetari i komunës duhet të siguroj se njësitë kërkuese në bashkëpunim me zyrën e prokurimit bëjnë një analizë të detajuar të vlerësimit të nevojave që të arrihet shfrytëzimi sa më ekonomik i fondeve publike.
9	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të siguroj se bëhet planifikim i mirëfilltë i buxhetit, duke forcuar disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë dhe të marr masat e duhura për menaxhimin obligimeve për të evituar proceset gjyqësore të cilat bartin shpenzime shtesë.
10	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetjake apo fonde tjera të financimit.
11	Pasuritë kapitale	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale, të krijojë një

	dhe jokatipale	sistem efikas të komunikimit dhe raportimit të të dhënave mes drejtorive dhe ZKF-së në mënyre që informatat e shpalosura në PFV të jenë të sakta dhe të besueshme për përdoruesit dhe palët e jashtme, të funksionalizojë sistemin e pasuria nëpër të gjitha drejtoritë si dhe të hartojë rregullore dhe procedura të brendshme për menaxhimin e pasurive. Të gjitha këto për menaxhim efektiv të pasurive me qëllim që regjistrat kontabël të paraqesin gjendjen reale të pasurive.
12	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve për rritjen e arkëtimeve.
13	Detyrimet	Kryetari duhet të ndërmarrë masa shtesë të respektohet Rregulla financiare nr. 02/2013, që raportimi i detyrimeve të papaguara të bëhet në Thesar në baza mujore. Për më tepër të delegohet përgjegjësia të zyrtari i caktuar, i cili do të menaxhoj procesin që nga pranimi i faturës, protokolimin e saj dhe dorëzimi për ekzekutim (pagesë) ndaj furnitorit.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Istogut, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Haki Rugova - Kryetar i Komunës së Istogut

Data: 30.07.2020

